

PARARENDËSIT E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Të drejtat e njeriut janë trajtuar në veprat e mendimtarëve të ndryshëm: filozofëve, politologëve, sociologëve të shek. **XVI, XVII dhe XVIII (Lloku, Lajbnici, Spinoza, Volteri, Ruso, etj.)**.

Shumica e tyre ishte nën ndikimin e **Shkollës së të drejtave natyrore**. Të drejtat e njeriut, sipas tyre, janë përcaktuar nga **“ligji natyror”** ose **“ligji hyjnor”**.

“Ligji natyror” ose “ligji hyjnor” e obligon çdo njeri që të :

1. **Veprojë** në përputhje me natyrën racionale të njeriut, dhe
2. **Përmbahet** ose që të **rezervohet** nga veprimet që janë në kundërshtim me ato ligje.

Sipas Hygo Grociusit, e **drejta natyrore është e pandryshueshme**. Ajo që, sipas natyrës së saj të brendshme, është e keqe, mbetet e keqe, sikurse që 2+2 bëjnë 4 dhe nuk mund të ndryshohet nga askush.

Këto të drejtat fitohen me **lindjen e njeriut** dhe janë:

- **të pacënueshme,**
- **të pandryshueshme,**
- **të përgjithshme, (universale),**
- **të përjetshme,**
- **të patjetërsueshme,**
- **të pazhdukshme,**
- **të paparashkrueshme,**
- **të njëjta për të gjithë njerëzit,**
- **në të gjitha vendet, për të gjithë popujt dhe për të gjitha kohërat.**

Të drejtat e njeriut janë të **dhëna nga krijuesi** (zoti, natyra, arsyeja që është në pajtim me natyrën).

Të drejtave të njeriut **nuk mund t’u kundërvihen të drejtat e tjera.**

Ato nuk mund të transferohen nga një njeri ose nga një grup, në tjetrin, as mund të abrogohen.

Atyre nuk u duhet as interpretues as ekzekutues të rinj.

Spinoza u fokusua **në njohjen e lirisë së mendimit dhe të fjalës**. Sipas tij, këto të drejta janë vlera të pazëvendësueshme në jetën politike dhe shoqërore. Këto të drejta nuk janë në kundërshtim me sistemin demokratik. Përkundrazi.

Liria e mendimit dhe e fjalës **nuk është e rrezikshme për paqen në shtet as armiqësore për pushtetmbajtësit**. Përmes të drejtës së lirisë së mendimit dhe fjalës, **manifestohet liria, që është qëllim i shtetit demokratik.**

Askush nuk mund ta detyrojë njeriun të flasë sipas recetave të pushtetit suprem, pa pasoja fatale.

VOLTERI afirmonte **lirinë e fjalës, barazinë dhe veprimin** me të tjerët, ashtu siç dëshirohet të veprohet me ty. Këto rregulla burojnë nga **ligjet natyrore**, që vlejnë për të gjithë njerëzit dhe për të gjithë popujt dhe janë në përputhje të plotë me ligjet e moralit.

Volteri kritikonte shoqërinë feudale dhe kishën katolike për pabarazinë shoqërore, mostolerancën fetare dhe arbitrarizmin e pushtetit mbretëror.

Ruso kishte ndikim me peshë në mendimin politik të kohës së tij. Kritikonte rendin e atëhershëm shoqëror të bazuar në pabarazi, që ishte mohim **“i gjendjes natyrore”, në të cilën të gjithë njerëzit ishin njësoj të lirë dhe të barabartë ekonomikisht dhe politikisht.**

Sipas tij, ekzistonte vetëm pabarazia fizike dhe pabarazia e aftësive intelektuale ndërmjet njerëzve, por, këto pabarazi ndërmjet njerëzve, janë të dorës së dytë, të parëndësishme.

Shteti, duke mbrojtur pronën private, kontribuon në krijimin dhe shtimin e kontradiktave mes të pasurve dhe të varfërve, mes sunduesve dhe të sunduarve. Kështu, sipas Ruso-s, nuk garantojnë drejtësi dhe paqja.

Njerëzit e lidhin “kontratën shoqërore”, **jo për t’iu nënshtruar pushtetit shtetëror, por për t’i ruajtur “të drejtat individuale njerëzore”: lirinë dhe barazinë, dhe për të mbrojtur, bashkërisht, secilin anëtar.**

Nga ky parim del e **drejta e popullit të ngritet kundër organeve shtetërore, nëse ato e kufizojnë lirinë e popullit dhe të drejtat njerëzore.**

Populli i cili e hedh zgjedhën “e kthen lirinë e vet, në bazë të të njëjtës të drejtë, që i është marrë liria”. (Populli ka të drejtë ta kthejë lirinë. Të tjerët nuk kanë pasur të drejtë t’ia marrin lirinë popullit).

TEST nga Lënda: Të drejtat e fëmijës dhe etika profesionale

1. Të drejtat e njeriut janë **trajtuar** në veprat e mendimtarëve, në shekujt:

.....

2. Të drejtat e njeriut, sipas pararendësve të të drejtave të njeriut, **burojnë** nga:

- a) ligjet natyrore,
- b) ligjet shoqërore.

3. Sipas H. Grociusit, të drejtat e njeriut kanë **karakter**:

- a)
- b)
- c)
- d)
- e)

4. Të drejtave të njeriut mund t'u **kundërvihen** të drejtat e tjera:
 - a) Po,
 - b) Jo.

5. Të drejtat e njeriut mund të **transferohen** nga një individ ose grup në tjetrin:
 - a) Po,
 - b) Jo.

6. Sipas Spinozës, **liria e mendimit dhe e fjalës**:
 - a) **e rrezikon** paqen në shtet,
 - b) **nuk e rrezikon** paqen në shtet.

7. Sipas Ruso, **rendi shoqëror feudal** ishte:
 - a) **mohim** i “të drejtës natyrore”,
 - b) **afirmim** i “të drejtës natyrore”.

8. Të drejtat e njeriut, sipas H. Grociusit, e **obligojnë** çdo njeri që:
 - a) vetëm **të veprojnë** në përputhje me natyrën racionale të njeriut, apo
 - b) edhe **të përmbahet** nga veprimet që janë në kundërshtim me natyrën racionale të njeriut.

9. Të drejtën e popullit **të ngritet kundër organeve shtetërore**, nëse atë e kufizojnë lirinë e popullit dhe të drejtat njerëzore, e ka afirmuar:
 - a) Grociusi,
 - b) Volteri,
 - c) Ruso.

AKTET E PARA TË TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE TË OYTETARIT

KARTA E MADHE E LIRIVE (KARTA MAGNA LIBERTATUM) 1215

Pa u mbështetur në ligj dhe në vendim të ligjshëm:

- Askush nuk mund të **burgoset**,
- Askush nuk mund të **privohet nga pasuria**,
- Askush nuk mund të **vihet jashtë ligjit**,
- Askush nuk mund të **dëbohet**.

LIGJI PËR TË DREJTAT (BILL OF RIGHTS) 1689

- E kufizon pushtetin absolutist,
- E garanton mbrojtje të të drejtave të njeriut.

Ligji për të Drejtat

- e shpall të paligjshëm pushtetin që pezullon ligjin ose që sundon pa ligj,
- u jep të drejtë qytetarëve t'i parashtrajnë peticione mbretit,
- i shpall të paligjshme urdhërat për ndjekje të parashtruesve të peticioneve,
- ndalon sulmet ose hetimet, jashtë parlamentit (në gjyq, etj.), për fjalimet, diskutimet ose veprimet në parlament.

DEKLARATA PËR PAVARËSINË E SHBA-ve 1776

- Krijuesi i ka krijuar të gjithë njerëzit të bababartë,
- Ai ua ka dhënë atyre disa të drejta të patjetërueshme:
 - a) jeta,
 - b) liria,
 - c) kërkimi i lumturisë.
- qeveritë janë krijuar për t'i siguruar këto të drejta,
- qeveritë i nxjerrin autorizimet e tyre nga pajtimi i njerëzve, mbi të cilët ushtrohet pushteti.

Rrjedhimisht:

Kur qeveria bëhet pengesë për jetësimin e këtyre qëllimeve, populli, në çdo kohë, ka të drejtë ta ndërrojë ose ta pezullojë qeverinë dhe të formojë qverinë e re, si i duket më së miri, për të arritur lirinë dhe lumturinë.

Pra, Deklarata për Pavarësinë e SHBA-ve proklamon:

1. Të drejtën e sovrانيتit, që i takon popullit,
2. Të drejtën e revolucionit për t'u dhënë fund padrejtësive.

DEKLARATA PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE TË QYTETARIT 1789

Njerëzit lindin dhe jetojnë të barabartë në të drejta.

Qëllimi i çdo rendi politik është të mbrojë të drejtat natyrore dhe të patjetërueshme të njeriut:

1. Liria,
2. Prona,
3. Siguria dhe
4. Rezistenca ndaj shtypësit.

Deklarata e DNQ-së shpall:

- **të drejtën e fjalës,**
- **të drejtën e shkrimit, dhe**
- **të drejtën e shtypit.**

Deklarata **ndalon që dikush të jetë i shqetësuar për shkak të bindjes së tij.**

Kufinj të lirive të njeriut janë të përcaktuar vetëm me ligj.

(Ligji është shprehje e vullnetit të përgjithshëm të popullit).

Ligji duhet të jetë **i njëjtë për të gjithë, qoftë kur mbron qoftë kur ndëshkon.**

Pra, të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit.

Kjo do të thotë: çdo **detyrë, post dhe shërbim publik, mund t'i jepet çdo qytetari, sipas aftësive të tij dhe pavarësisht nga çdo dallim ndërmjet tyre,** përveç **dallimeve në virtytet dhe talentet e tyre.**

Përkufizimi i lirisë, si e drejtë e njeriut, në DDNQ: **njeriu mund të bëjë gjithçka, për aq sa nuk i bën dëm tjetërkujt.**

Pra, **shfrytëzimi i të drejtave natyrore të çdo njeriu, varet ose kufizohet nga të drejtat që u janë siguruar anëtarëve të tjerë të shoqërisë.**

Pushteti publik, i cili garanton të drejtat e njeriut dhe të qytetarit, është themeluar **për interesin e përgjithshëm, jo për interesin e atyre që u është besuar pushteti publik.**

Deklarata:

- **ndalon akuzat, burgosjet dhe mbajtjen arbitrare në burg, pa u bazuar në ligj, dhe**
- **dënon ata që nxisin, kryejnë ose mundësojnë kryerjen e urdhërave arbitrare.**

Deklarata ka dispozita që edhe sot konsiderohen **parime themelore të procedurës gjyqësore,** në të gjitha vendet e qytetëruara:

- **Askush nuk mund të dënohet, përveç në bazë të ligjit, të shpallur para kryerjes së deliktit,**
- **Cdo njeri konsiderohet i pafajshëm, derisa të mos konstatohet faj i tij,**
- Në rast të burgimit të domosdoshëm **ndalohet rreptësisht çdo masë e ashpër,** që **nuk do të ishte e nevojshme.**

Të drejtat e njeriut të DDNQ, të vitit 1789, janë konfirmuar dhe janë zgjeruar në **Deklaratën për të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit, të vitit 1793.** Në të përsëriten të drejtat e njeriut, të deklaratës së parë dhe **shtohen edhe disa të drejta të reja:**

- E drejta e parashtrimit **të peticionit bartësve të pushtetit publik,**
- E drejta **për kryengritje,** kur qeveria i cënon të drejtat e popullit (**kjo është e drejta më e shenjtë dhe detyra më e domosdoshme,**
- E drejta e **tubimit paqesor,**
- E drejta e **ushtrimit të riteve religjioze,**
- **Detyra për të ndihmuar shoqërinë** , për t'i siguruar qytetarët që janë në pozitë të vështirë (sigurimi i punës, sigurimi i mjeteve për ekzistencë atyre që nuk janë të aftë për punë),
- **Krijimin e mundësive për shkollimin e të gjithë qytetarëve.**

Aktet e të drejtave të njeriut i bëjnë të paligjshme **kufizimet dhe privilegjet në shoqërinë feudale dhe pushtetin absolut të monarkëve.**

Ato janë **fitore për njohjen dhe afirmimin e të drejtave të njeriut.**